



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr. 127 / prot

Tiranë më 14.10.2025

URDHËR

Nr. 128 , Date 14 / 10 / 2025

**“PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË
KANDIDATËVE PËR PUNONJËS PRANË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR
GJYQËSOR SHETËTOR”**

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” dhe Ligjit nr. 8/2023, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”

URDHËROJ:

1. Miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe punonjësve administrativë pranë Zyrave Vendore Përmbarimore Gjyqësore si dhe anekseve bashkëlidhur kësaj metodologjie si vijon:

Aneks nr. 1-Tabela e vlerësimit sipas dokumentave në dosjen vetjake;

Aneks nr. 2-Tabela e vlerësimit të performancës nga intervista me gojë;

Aneks nr. 3-Tabela e vlerësimit të përgjigjes së pyetjeve nga intervista me shkrim;

Aneks nr. 4-Tabela e vlerësimit përfundimtar të kompetencës profesionale;

Aneks nr. 5-Vendim për caktimin e kandidatëve me rezultatet më të larta.

2. Ngarkohet “Komisioni për zhvillimin e procesit të konkurimit për vende të lira pune dhe procedural të konkurimit” për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ERGYS QIRICI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr. 1271/prot,

Tiranë më 14.10.2025

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË KOMPETENCËS PROFESIONALE TË PUNONJËSVE TË SHËRBITIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHITETËROR

Vlerësimi i kompetencës profesionale do të arrihet përmes vlerësimit të arritjeve në tre fusha:

- A. Vlerësimi i arsimimit, përvojës profesionale dhe trajnimet të dokumentuara në dosjen vetjake
- B. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve nga konkurimi me shkrim
- C. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve gjatë intervistës të strukturuar me gojë

Për secilën fushë, do të përdoret sistemi i mëposhtëm të treguesve dhe pikët për secilin prej tyre.

A. Vlerësimi i arsimimit, përvojës profesionale dhe trajnimet të dokumentuara në dosjen vetjake

- 1. *Diplomimi* (15 pikë total)
 - a. Master Profesional (5 pikë)
 - b. Master Shkencor (10 pikë)
- 2. *Përvoja profesionale, eksperiencia të mëparshme, kualifikime* (10 pikë në total)
 - c. Vjetërsia në profesion (5 pikë)
 - d. Kualifikime kompjuteri (2 pikë)
 - e. Kualifikim Gjuhe e huaj (2 pikë)
 - f. Të tjera çertifikime (1 pikë)
- 3. *Të tjera arritje* (5 pikë në total)
 - a. Krijime
 - b. Të tjera aftësi

B. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve nga konkurimi me shkrim

- 4) *Testimi me shkrim* (50 pike total)
 - a. Testimi me shkrim do të përmbajë gjithsej 5 pyetje teorike dhe kazuse nga sferat ligjore dhe profesionale. Secila pyetje do të vlerësohet me maksimumin 10 pike. Koha në dispozicion 30 min.

C. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve gjatë intervistës të strukturuar me gojë

- 5) *Intervista e strukturuar me gojë* (20 pike total)
 - Misioni dhe vizioni, prioritetet dhe objektivat (10 pikë)
 - Vetëvlerësimi dhe motivimi (10 pikë)

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Koha maksimale është 10 min për çdo kandidat.

Vlerësimi përfundimtar i kompetencës profesionale arrihet nëpërmjet rezultatit përfundimtar bazuar në treguesit e paraqitur në tabelë

Emër Mbiemër	Vlerësimi i arritjeve të dokumentuara në dosjen vetjake	Vlerësimi i produkteve nga konkurimi me shkrim	Vlerësimi i performancës nga intervista me gojë	Totali pikë Deri në 100 pikë
	Deri 30 pikë	Deri 50 pikë	Deri 20 pikë	

Kandidatët me vlerësim total më të ulët se 40 pikë nga 100 pikë të mundshme nuk bëhen pjesë e listës së kandidatëve fitues për pozicionin vakant.

Nëse për të njëjtin pozicion shpallen 2 dhe më shumë vende vakante me të njëjtat detyra funksionale, kandidatët fitues do të jenë nga renditja e dy ose më shumë kandidatëve me pikët më të larta.

Bashkëlidhur metodologjisë gjenden:

- Aneks nr. 1-Tabela e vlerësimit të arritjeve të dokumentuara në dosjen vetjake;
- Aneks nr. 2-Tabela e vlerësimit të performancës nga intervista me gojë;
- Aneks nr. 3-Tabela e vlerësimit të performancës nga intervista me shkrim;
- Aneks nr. 4-Tabela e vlerësimit përfundimtar të kompetencës profesionale;
- Aneks nr. 5-Vendim për propozimin e kandidatëve me rezultatet më të larta.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ERGYS QIRIÇI

